



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

Udhëzim

“Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar”¹

I. Objekti dhe Qëllimi i Udhëzimit

1. Funksionimi efikas i tregjeve dhe ekzistenca e konkurrencës efektive, janë parime themelore që mbështesin ekonominë e tregut, e cila drejton dhe inkurajon produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë në përgjithësi, në dobi të konsumatorëve. Këto parime, janë gjithashtu me shumë rëndësi për hartimin dhe përcaktimin e politikave që rregullojnë aktivitetet ekonomike.
2. Autoriteti i Konkurrencës gjatë veprimtarisë së tij ka parasysh parimet e ligjshmërisë, transparencës, të drejtës së informimit, konfidencialitetit, proporcionalitetit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, jo-diskriminimit, të përcaktuara në ligjin nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, në Kodin e Procedurave Administrative dhe në aktet e tjera ligjore në fuqi.
3. Për të siguruar një zbatim efektiv të rregullave të konkurrencës dhe njëkohësisht respektimin e të drejtave themelore të mbrojtjes, Udhëzimi parashikon rregulla praktike mbi procedurat e Autoritetit të Konkurrencës (këtu e më poshtë AK).
4. Në përputhje me Ligjin nr. 44/2015, Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë (këtu e më poshtë KPrA, ligji nr. 44/2015), ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e më poshtë ligji 9121/2003), Rregullorja “Për Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” (këtu e më poshtë Rregullorja e Funksionimit), Rregullorja "Për procedurat hetimore në Autoritetin e Konkurrencës" (këtu e më poshtë Rregullorja për procedurat) udhëzimi parashikon procedurat kryesore që ndiqen në rastet e shkeljeve të neneve 4 dhe 9 të ligjit 9121/2003.
5. Procedurat në lidhje me zbatimin e neneve 4 dhe 9 rregullohen me ligjin 9121/2003 si dhe me aktet nënligjore në fuqi.
6. Qëllimi kryesor i këtij udhëzimi, është të sigurojë udhëzime praktike për zhvillimin e procedurave, në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit 9121/2003.

¹ Commission notice on best practices for the conduct of proceedings concerning Articles 101 and 102 TFEU / (2011/C 308/06)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

7. Në këtë drejtim, udhëzimi përcakton hapat që ndjek procesi hetimor nga ana e AK dhe në këtë mënyrë forcon efikasitetin e hetimeve duke ofruar një shkallë të lartë të transparencës së procesit. (në mënyrë që të sjellë siguri/mbrojtje juridike).

II. Fillimi i një procedure

8. Në zbatim të neneve 41, 42 dhe 43 të ligjit nr. 44/2015 dhe nenit 29/1 të ligjit nr. 9121/2003, një rast në lidhje me shkelje të pretenduar të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, mund të bazohet në një ankesë nga ndërmarrjet ose me vetë iniciativën e AK.
9. Neni 41 i ligjit nr. 9121/2003 gjithashtu parashikon mundësinë që ti kërkohet AK nga institucione si Parlamenti ose rregullatorët e tjerë për të kryer një hetim të përgjithshëm në ndonjë sektor të ekonomisë.
10. Informacione, të cilat janë të rëndësishme në nxitjen e hetimeve nga Autoriteti, mund të merren edhe nga qytetarët apo edhe nga ndërmarrjet,. Prandaj, AK inkurajon qytetarët dhe ndërmarrjet që ta informojë për shkelje të dyshuar të rregullave të konkurrencës. Kjo mund të bëhet ose me paraqitjen e një ankese zyrtare ose thjesht duke i dhënë AK informacione për tregun. Procedura që ndiqet në rastin e ankesave është pasqyruar në Rregulloren e Funksionimit dhe Rregulloren e Procedurave.
11. AK mund të hapë një rast me iniciativën e tij. Këtë nismë mund ta ndërmarrë kur AK disponon fakte/të dhëna të caktuara në lidhje me një rast, ose në rastet kur këto të dhëna janë siguruar dhe informacioni është mbledhur në kontekstin e ndonjë pyetësi në ndonjë sektor të ekonomisë, takimeve informale me përfaqësues të industrisë, apo nga monitorimi i tregjeve. Rastet lidhur me marrëveshje të ndaluara gjithashtu mund të iniciohen në bazë të një aplikimi për lehtësim nga gjrobat.

II.1. Ankesat

12. Në zbatim të nenit 29/1 të ligjit nr.9121/2003, ankesat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenet 28-29 të Rregullores së Funksionimit. Këto ankesa do të trajtohen bazuar në nenin 30 të Rregullores së Funksionimit si dhe në nenin 13 të Rregullores për Procedurat.

III. PROCEDURAT HETIMORE

III.1. Hetimi paraprak-Masat hetimore

13. Të gjitha rastet, pavarësisht nga mënyra se si fillon një rast, i nënshtrohen një faze fillestare të vlerësimit. Në zbatim të nenit 35 ligji nr. 9121/2003 dhe nenit 27 të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Rregullores së Funkcionimit, gjatë kësaj faze AK do të kryejë hetimet e nevojshme. Gjatë kësaj faze, AK shqyrton nëse çështja do të kalojë në hetime të mëtejshme dhe nëse po, përcakton veçanërisht palët, tregjet dhe sjelljen që do të hetohet.

14. Vlerësimi fillestar nënkupton që në disa raste nuk do të vijojnë procedura hetimore sepse nuk konsiderohet se rasti meriton hetime të mëtejshme, duke mos qenë objekt i ligjit. Në këtë drejtim, AK përqendron burimet e tij njerëzore në rastet kur duket se potencialisht mund të zbulohet një shkelje, duke siguruar zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit.
15. Kërkesa për informacion, si dhe inspektimi, mund të jetë një nga masat e para hetimore. Kërkesa për informacion mund të bëhet si para, ashtu edhe pas hapjes së procedurës.
16. Kur masa e parë hetimore u drejtohet ndërmarrjeve (normalisht një kërkesë për informacion ose një inspektim), adresuesit informohen për faktin se ata janë subjekt i një hetimi paraprak, duke i informuar edhe për rastin dhe qëllimin e një hetimi të tillë.

Kërkesa për informacion

17. Në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 9121/2003, AK është e autorizuar t'u kërkojë ndërmarrjeve dhe bashkimeve të ndërmarrjeve, që t'i sigurojnë të gjitha informacionet e nevojshme. Informacioni mund të kërkohej me shkresë të Sekretariatit ose me vendim të KK, sipas përcaktimeve të dispozitave të ligjit 9121/2003.
18. Duhet të theksohet fakti se kërkesat për informacion, mund të dërgohen jo vetëm për ndërmarrjet nën hetim, por edhe për ndërmarrjet ose bashkimet e tjera të ndërmarrjeve, që mund të kenë informacione të rëndësishme për rastin. Informacioni është i nevojshëm, veçanërisht kur i lejon Komisionit të verifikojë ekzistencën e shkeljes së pretenduar të përmendur në kërkesë.
19. Informacioni është i nevojshëm veçanërisht nëse do të mundësojë AK që të verifikojë ekzistencën e shkeljes. Kur kërkesës për informacion, ndërmarrjet i përgjigjen me informacionin jo të duhur dhe dokumente të cilat nuk lidhen me rastin, AK mund tja kthejë adresuesit këtë lloj informacioni.
20. Adresuesi i një kërkesë për informacion, mbrohet nga parimi-privilegji i vetë-inkriminimit.
21. Kërkesa për informacion përcakton se cilat informacione kërkohen dhe përcakton afatin kohor brenda të cilit do të sigurohet informacioni, në kushtet e përcaktuara në nenin 8 të Rregullores së Procedurave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

22. Adresuesve u jepet një afat kohor i arsyeshëm për t'iu përgjigjur kërkesës. Në këtë rast AK mban në konsideratë kompleksitetin e rastit dhe të kërkesës për informacion. Në rastet kur objekti i kërkesës është i kufizuar, p.sh. në rastet kur përmban vetëm një sqarim në lidhje me informacione të depozituara më parë ose depozitim informacioni i cili është i disponueshëm, afati kohor do të jetë më i shkurtër.
23. Nëse ndërmarrjet kanë vështirësi në kthimin e përgjigjes dhe depozitim të informacionit brenda afateve kohore të përcaktuara, ata mund të kërkojnë AK që të zgjasë këtë periudhë kohore. Në këtë rast, duhet të bëhet një kërkesë me shkrim, para mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në kërkesën e AK. Nëse AK e vlerëson të bazuar kërkesën, në varësi të rastit dhe kompleksitetit të informacionit që është kërkuar, atëherë i jep ndërmarrjeve kohë shtesë për të depozituar informacionin e kërkuar. AK mund t'i kërkojë ndërmarrjeve që një pjesë të informacionit të kërkuar, i cili gjendet lehtësisht dhe është i disponueshëm, të depozitohet pranë zyrave të AK në një periudhë kohore më të shkurtër, ndërkohë që kohë shtesë jepet për pjesën tjetër të informacionit që do të depozitohet.
24. Kërkesa për informacion, gjithashtu kërkon që adresuesi, të tregojë nëse ai e konsideron informacionin e dhënë në përgjigje si konfidencial. Në këtë rast, adresuesi, duhet të sigurojë një version jo konfidencial të informacionit.
25. Versioni jo-konfidencial i informacionit duhet të depozitohet në të njëjtin format si versioni konfidencial, në të cilin janë zëvendësuar paragrafët. Në përgjithësi, versioni jo konfidencial duhet të depozitohet në të njëjtën kohë me dokumentet e tjera. Nëse ndërmarrjet nuk i zbatojnë këto kërkesa, AK mund të supozojë se dokumentet ose deklaratat në fjalë nuk përmbajnë informacion konfidencial.
26. Gjatë fazës hetimore, AK mund të zhvillojë takime (ose të kryejë thirrje telefonike) me palët që i nënshtrohen procedurave, me ankuesit ose palët e treta.
27. Kur zhvillohet një takim bazuar në kërkesën e palëve, ankuesve ose palëve të treta, në përgjithësi, ato duhet të depozitojnë paraprakisht një agjendë lidhur me çështjet që do të jenë objekt diskutimi në këtë takim, dhe nëse konsiderohet e përshtatshme edhe një prezantim i cili përfshin çështjet më me detaje.
28. Çdo dokument i shkruar i përgatitur nga palët pjesëmarrëse në këto takime, do të jetë pjesë e dosjes. Një version jo konfidencial i këtij dokumentacioni, mund të bëhet i aksesueshëm për palët nën hetim përgjatë fazës së aksesit në dosje, nëse çështja ka vijuar më tej. AK mund të kërkojë palëve pjesëmarrëse në këtë takim, që të depozitojnë gjithë informacionin, në mënyrë shkresore.
29. Ligji dhe rregulloret parashikojnë edhe mundësinë e marrjes së deklaratave nga personat fizikë dhe juridikë, të cilët mendohet se mund të disponojnë informacion të vlefshëm në lidhje me shkeljen e pretenduar. Për këtë arsye, AK mund të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

intervistojë (edhe me telefon ose video konferencë) çdo person fizik dhe juridik, i cili jep pëlqimin për tu intervistuar me qëllim mbledhjen e informacionit. Në këtë rast, intervistuesi informohet mbi bazën ligjore të intervistës, natyrën vullnetare të saj si dhe mundësinë për tu këshilluar me një avokat. AK e informon në lidhje me qëllimin e intervistës dhe regjistrimin e saj.

Inspektimet

- 30.** Në zbatim të neneve 36 dhe 37 të ligjit nr.9121/2003 dhe nenit 9 të Rregullores së Procedurave, në kuadër të një hetimi, AK ka të drejtë të kryejë inspektime në ambientet e një ndërmarrjeje dhe në rrethana të caktuara në ambiente të tjera, përfshirë ambientet private.

Privilegji profesional juridik

- 31.** Disa lloje komunikimesh konfidenciale, midis avokatëve të jashtëm ose të pavarur dhe klientëve të tyre, mund të mbrohen nga parimi i Privilegjit Profesional Juridik (i referuar gjithashtu si "Marrëdhëniet Avokat/Klient"/LPP²). Këto komunikime, mbrohen nga privilegji juridik profesional, me kusht që ato janë bërë për qëllimin dhe interesin e ushtrimit të të drejtave të mbrojtjes së klientit në procedurat që ndiqen në një rast të konkurrencës.
- 32.** Palët duhet të paraqesin para AK justifikimin e përshtatshëm lidhur me këtë pretendim duke ofruar edhe versione të redaktuara, në të cilat janë hequr ato pjesë të cilat janë nën mbrojtjen e parimit LPP. Në disa raste, një shikim tërthor i këtyre dokumenteve nga përfaqësuesit e AK zakonisht gjatë një inspektimi (zakonisht lënda/objekti i shkresës apo komunikimit, titulli, ose elementë të tjerë sipërfaqësor) i mundëson ata të arrijnë në konkluzionin nëse bëhet fjalë për lloje të tilla dokumentesh. Megjithatë, mund të këtë raste, kur ndërmarrja nuk e lejon edhe një gjë të tillë, pasi një shikim i tillë nuk mund të kryhet pa dekonspiruar përmbajtjen e dokumentit.
- 33.** Hetimi paraprak përfundon me Raportin Paraprak të Hetimit.

III.2 Hetimi i thelluar (Hapja e procedurave)

- 34.** AK hap procedurat sipas nenit 43 të ligjit nr. 9121/2003, kur nga vlerësimi fillestar arrihet në përfundimin se nevojiten të kryhen hetime të mëtejshme.
- 35.** Vendimi për hapjen e procedurave përcakton palët subjekt të procedurës dhe përshkruan shkurtimisht objektin/qëllimin e hetimit. Në veçanti, ai përcakton

² Legal Professional Privilege



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

- sjelljen që nënkupton shkeljen potenciale të neneve 4 ose 9 të ligjit nr. 9121/2003 që do të përfshijë hetimi dhe mund të identifikojë territorin dhe sektorin (et) ku ndodh ajo sjellje.
36. Në zbatim të nenit 47 të ligjit nr.9121/2003, AK publikon hapjen e procedurave.
37. Neni 5 (3) i Rregullores së Procedurave përcakton se vendimi i KK për të filluar një hetim të thelluar, përcakton afatin kohor brenda të cilit palët nën hetim si dhe palët e tjera të interesuara mund të shprehin mendimet e tyre rreth vendimit.
38. Megjithëse nuk ka asnjë detyrim ligjor në këtë drejtim, palët që janë subjekte të hetimit, duhet të informohen paraprakisht për hapjen e procedurave, përpara se të bëhet publik ky proces.
39. Hapja e procedurave nuk paragjykon në asnjë mënyrë ekzistencën e një shkelje. Thjesht tregon që AK do të ndjekë më tej çështjen.
40. Hapja e procedurave nuk e kufizon të drejtën e AK, për të zgjeruar objektin dhe / ose palët nën hetim, në një moment të mëvonshëm.
41. Aktualisht, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, një hetim i thelluar duhet të kryhet për një periudhë prej 6 muajsh, por kjo periudhë mund të zgjatet. Mund të ndryshohet në të ardhmen, duke parashikuar zgjatjen e kësaj periudhe kohore.
42. Pasi Sekretariati të ketë arritur një konkluzion lidhur me çështjet kryesore të ngritura nga një çështje, ai harton një Raport Përfundimtar të Hetimit që përmban një nga propozimet e mëposhtme:
- Të vijohet drejt miratimit të një vendimi ndalimi në lidhje me të gjitha ose disa nga çështjet e identifikuara në hapjen e procedurave.
 - Sekretariati mund të arrijë në konkluzionin se nuk ka arsye për të vazhduar procedurën në lidhje me të gjitha ose disa nga palët dhe propozon që të mbyllet procedurat.

IV. Raporti Hetimor

43. Një hap i rëndësishëm procedural në procedurat që mund të çojnë në një vendim ndalimi, është miratimi i Raportit Përfundimtar të Hetimit (*Statement of Objections/Deklarata e Kundërshtive*) nga Sekretariati. Sidoqoftë, miratimi i Raportit Përfundimtar të Hetimit, nuk paragjykon rezultatin përfundimtar të hetimit. Kjo mund të çojë në mbylljen e çështjes, pa miratimin e një vendimi ndalimi ose një vendim angazhimi nga Komisioni.
44. Raporti Përfundimtar i Hetimit, përcakton pozicionin paraprak të Sekretariatit lidhur me shkeljen e pretenduar, pas kryerjes së një hetimi të thelluar. Qëllimi i tij është të informojë palët në fjalë, për pretendimet e ngritura kundër tyre, me qëllim që t'u mundësojë atyre të ushtrojnë të drejtën e tyre për tu mbrojtur, me shkrim ose me gojë në seancë dëgjimore. Kështu, ai përbën një mbrojtje thelbësore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

- procedurale, e cila siguron që të respektohet e drejta për tu dëgjuar. Palëve duhet t'ju ofrohet i gjithë informacioni i nevojshëm që ju nevojitet për tu mbrojtur dhe për të komentuar në lidhje me shkeljet e pretenduara ndaj tyre.
- 45.** Kjo e drejtë përforcohet nga neni 19 (2) i Rregullores së Procedurave, i cili thotë se Komisioni do t'i bazojë vendimet e tij për shkeljet, vetëm mbi pretendime mbi të cilat palëve nën hetim u është dhënë mundësia të shprehin mendimet dhe këndvështrimet e tyre.
- 46.** Pavarësisht se nuk ka detyrim ligjor, Raporti Përfundimtar i Hetimit duhet të tregojë qartë nëse Sekretariati propozon vendosjen e gjobave për ndërmarrjet. Gjithashtu do të tregojë faktet thelbësore dhe aspektet e ligjit, që mund të përmbajnë elementë për vendosjen e gjobës, siç është kohëzgjatja dhe rëndësia e shkeljes dhe nëse shkelja është kryer me dashje ose nga pakujdesia. Raporti Përfundimtar i Hetimit do të përmendë gjithashtu faktet të cilat mund të çojnë në rrethana rënduese dhe ato të cilat çojnë në rrethana lehtësuese.
- 47.** Edhe pse nuk ka asnjë detyrim ligjor në këtë drejtim, për të rritur transparencën, Raporti Përfundimtar i Hetimit mund të përfshijë (duke përdorur informacionin e disponueshëm) çështje të rëndësishme për çdo llogaritje të mëvonshme të gjobave, duke përfshirë shifrat përkatëse të shitjeve që do të merren parasysht dhe vitin që do të merret në konsideratë për vlerën e shitjeve. Një informacion i tillë mund t'u jepet palëve pas Raportit Përfundimtar të Hetimit. Në të dyja rastet, palëve do t'u jepet mundësia për të komentuar.
- 48.** Palëve në një procedurë u jepet mundësia për tu dëgjuar nga KK para miratimit të një vendimi, i cili mund të prekë interesat e tyre. Palët gjithashtu mund të paraqesin argumentet e tyre në seancën dëgjimore, për çështjet që mund të kenë rëndësi lidhur me vendosjen e gjobave. Edhe pse nuk është parashikuar asnjë detyrim ligjor, me qëllim respektimin e parimeve të transparencës, AK mund të botojë një njoftim për shtyp, ku përcakton çështjet kryesore të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Hetimit, menjëherë pasi palët të kenë marrë dijeni për të. Kjo deklaratë për shtyp, nuk paracakton rezultatin përfundimtar të procedurave apo vendimin përfundimtar i cili merret vetëm pasi të jenë dëgjuar palët.
- 49.** Palëve ju garantohet e drejta për të aksesuar dosjen hetimore me qëllim që tu jepet e drejta të shprehin këndvështrimet e tyre lidhur me konkluzionet e raportit. Procedurat lidhur me të drejtën e aksesit janë parashikuar tek “Rregullorja e Procedurave”.
- 50.** Respektimi i parimit mbi aksesin në dosje, varet edhe nga bashkëpunimi i palëve dhe ndërmarrjeve të cilat kanë ofruar informacionin që përmban dosja. Siç është përmendur, ndërmarrjet duhet të sigurojnë një version jo konfidencial të informacionit të depozituar. Një version i tillë jo konfidencial duhet të ofrohet në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

të njëjtin format ashtu si dhe informacioni konfidencial duke zëvendësuar paragrafët e fshirë, me një përmbledhje të tyre. Përveçse kur është rënë dakord ndryshe, versioni jo konfidencial duhet të ofrohet në të njëjtën kohë me versionin konfidencial.

- 51.** Në vendimin e tij KK në raste të veçanta, mund të marrë parasysh edhe pamundësinë e palëve për të paguar gjobën ose për ta reduktuar atë, në rastet kur gjoba në mënyrë të paevitueshme rrezikon ecurinë ekonomike të ndërmarrjeve. Në këtë rast, ndërmarrjet duhet të paraqesin informacione financiare të detajuara dhe të kohëve të fundit për të mbështetur kërkesën e tyre. Kur kryhet një vlerësim i tillë, AK duhet të marrë në konsideratë situatën financiare të viteve të fundit dhe një parashikim për vitin prezent dhe të ardhshëm, duke pasur parasysh fuqinë financiare, përfitueshmërinë, likuiditetin dhe lidhjet e ndërmarrjes me partnerë të tjerë dhe aktorë të tjerë në treg. Gjithashtu, merret parasysh situata sociale dhe ekonomike dhe fakti nëse një gjobë mund të ndikojë në uljen domethënëse të vlerës së aseteve të ndërmarrjes.

V. Marrja e një vendimi në lidhje me shkeljen e parimeve të konkurrencës

- 52.** Vendimet në lidhje me shkeljet e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003, në zbatim të neneve 26 dhe 45 të ligjit nr.9121/2003, miratohen nga Komisioni, me propozimin e Sekretariatit. Vendimet plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin 11 dhe 12 të Rregullores së Funkcionimit dhe nenit 18 të Rregullores së Procedurave.
- 53.** E drejta e palëve në procedurë, që të dëgjohen para se të merret një vendim i formës së prerë që prek interesat e tyre, është një parim themelor. AK është e përkushtuar të sigurojë që ushtrimi efektiv i së drejtës për t'u dëgjuar respektohet në procedurat e tij, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 9121/2003 dhe nenet 87-88 Ligjit 44/2015. Prandaj, para se të miratojë një vendim që konstaton shkelje të nenit 4 dhe 9 të ligjit 9121/2003, AK do t'u japë palëve subjekt të procedurave, mundësinë për t'u dëgjuar (me shkrim ose me gojë) për çështjet e ngritura.
- 54.** AK do t'i japë këtë të drejtë, duke i njoftuar lidhur me Raportin Përfundimtar të hetimit, të hartuar nga Sekretariati për secilën nga palët që janë subjekt i procedurës. Sekretariati kur dërgon Raportin, do të specifikojë një afat kohor brenda të cilit palët mund të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim.
- 55.** Afati kohor i përcaktuar për të depozituar pretendimet përkundrejt Raportit të Hetimit merr në konsideratë kohën që mund të nevojitet për të përgatitur këto pretendime, por në disa raste edhe urgjencën e një rasti. Duhet të merren në konsideratë veçanërisht madhësia dhe kompleksiteti i një rasti, nëse ndërmarrjet nën hetim kanë pasur të drejtën e aksesit në dosje, si dhe çdo element tjetër që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

- konsiderohet i rëndësishëm. Të adresuarit mund të kërkojnë një shtyrje të afatit kohor, nëpërmjet një kërkesë të arsyetuar me shkrim e cila shqyrtohet nga Autoriteti i Konkurrencës, i cili mund të vendosë për shtyrjen e këtij afati.
56. Përveç kësaj, adresuesve të Raportit të Hetimit, si dhe palëve të tjera të interesuara, u lejohet aksesi në dosjen e AK, në përputhje me nenin 45 (1) të Ligjit 44/2015, nenin 17 të Rregullores së Procedurave dhe nenin 6 (2) të Rregullores për Procedurat, në mënyrë që t'i lejojë ata të shprehin në mënyrë efektive pikëpamjet, këndvështrimet dhe pretendimet e tyre mbi përfundimet paraprake të arritura nga Sekretariati në Raportin e tij Përfundimtar Hetimor, para se KK të marrë një vendim.
 57. Në këtë kuptim, në përputhje me nenet 18 (2) dhe 19 (3) të Rregullores për Procedurat, palët njoftohen lidhur me mundësinë që do t'u jepet që të paraqesin me shkrim argumentet e tyre, kundër pretendimeve të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Hetimit kundër tyre, brenda afatit kohor të përcaktuar.
 58. Gjatë paraqitjes së deklaratave të tyre me shkrim, palët duhet të përfshijnë argumentet e tyre mbrojtës kundër pretendimeve të ngritura nga Sekretariati në Raportin e tij Përfundimtar të Hetimit. Ato mund të bashkëlidhin çdo dokument përkatës dhe mund t'i propozojnë Komisionit, që të dëgjojë edhe persona të tjerë që mund të mbështesin pretendimet e tyre.
 59. Në seancën dëgjimore, palët lejohen të sjellin dhe të paraqesin çdo argument që ata kanë depozituar me shkrim dhe të plotësojnë kur është e nevojshme me të dhëna dhe evidenca të tjera që ata i konsiderojnë të nevojshme për rastin. Fakti që seancat dëgjimore nuk janë publike, ju jep mundësinë palëve të shprehin lirisht gjithë pretendimet e tyre. Çdo informacion i zbuluar gjatë seancës dëgjimore do të përdoret vetëm në lidhje me procedurën administrative hetimore në fjalë, ose për atë gjyqësore në lidhje me të njëjtën çështje.
 60. Në zbatim të nenit 20 të Rregullores së Procedurave, e drejta për të paraqitur deklarata/prendime me shkrim u jepet edhe palëve të tjera, që duhet të paraqesin kundërshtimet/prendimet e tyre brenda afatit të përcaktuar.
 61. Nëse kërkohet në deklaratat e tyre me shkrim, Komisioni do t'i dëgjojë palët në një seancë dëgjimore.
 62. Kur është e nevojshme, palë të treta mund të ftohen të marrin pjesë në seancën dëgjimore, nëse persona të tillë e kanë kërkuar këtë në deklaratat e tyre me shkrim.
 63. Pas dëgjimit të palëve, dhe duke marrë parasysh deklaratat/prendimet e palëve lidhur me pretendimet e Sekretariatit, KK do të miratojë vendimin e tij përfundimtar, i cili mund të vendosë plotësisht ose për një pjesë të propozimeve të Sekretariatit ose refuzimin e tyre të pjesshëm ose të plotë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

- 64.** Prandaj, ekzistojnë vendime përfundimtare të ndryshme të mundshme në këtë fazë:
- i. Nëse, duke marrë parasysh përgjigjet e palëve dhe në bazë të një vlerësimi të plotë të të gjitha informacioneve të marra deri në këtë fazë, pretendimet janë të vërtetuara, KK do të procedojë drejt miratimit të një vendimi që konstaton shkelje të neneve 4 ose 9 të ligjit nr.9121/2003;
 - ii. KK gjithashtu mund të vendosë të heqë disa pretendime dhe të vazhdojë drejt vendimit që konstaton shkelje për pjesën e mbetur;
 - iii. Nëse, pretendimet në këtë fazë nuk vërtetohen, KK mbyll çështjen.
- 65.** Megjithëse nuk ka asnjë detyrim ligjor në këtë drejtim, propozimi i Sekretariatit mund të përfshijë në Raport, pretendimet e palëve lidhur me Raportin Përfundimtar të Hetimit të bëra nga palët gjatë seancës.
- 66.** Menjëherë pas miratimit të vendimit, palët do të informohen për vendimin, në zbatim të dispozitave zyrtare të njoftimit të përcaktuara në nenin 25 të Rregullores së Procedurave.
- 67.** Në interes të transparencës, në përputhje me nenet 47/2 të ligjit nr.9121/2003 dhe 12 të Rregullores së Funkcionimit, një version jo konfidencial i vendimeve të AK do të publikohet në Buletinin e Vendimeve Zyrtare të AK dhe në faqen zyrtare të AK.
- 68.** Edhe pse nuk ka asnjë detyrim ligjor, një njoftim për shtyp që përshkruan qëllimin e çështjes dhe natyrën e shkeljes mund të kontribuojë në rritjen e vizibilitetit të AK dhe kulturës së konkurrencës në shoqëri.

VI. Procedura të tjera

VI.1. Masat e përkohshme

- 69.** Në mbështetje të nenit 44 të ligjit nr.9121/2003, nenit 11 të Rregullores së Procedurave dhe neneve 67-68 të KPrA, Komisioni në çdo kohë të procedurës, mund të miratojë masa të nevojshme të përkohshme në rastet e urgjencës për shkak të një rreziku serioz dhe të pariparueshëm që shkakton dëm në konkurrencë, në kuptim të nenit 61, geramat c), ç), d) dhe dh).

VI.2. Procedurat e angazhimit

- 70.** Neni 45/2 i ligjit nr. 9121/2003, parashikon mundësinë që ndërmarrjet të ofrojnë angazhime që synojnë të adresojnë dhe të zgjidhin shqetësimet e konkurrencës, të identifikuar nga Sekretariati.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

71. Rregullorja për Procedurat e Angazhimeve, përcakton rregullat dhe procedurat që zbatohen në rastet e përfundimit dhe mbylljes së hetimit duke marrë angazhime, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9121/2003.
72. Nëse KK i pranon këto angazhime, ai mund të marrë një vendim, i cili i bën ata të detyrueshëm për palët, pjesë e procedurave. Është në diskrecionin e KK nëse do të pranojë ose jo angazhime. Në respektim të parimit të proporcionalitetit, KK duhet të verifikojë që angazhimet adresojnë dhe zgjidhin shqetësimet e identifikuar të konkurrencës dhe se angazhimet e ofruara nuk tejkalojnë qartë ato që janë të nevojshme për të zgjidhur këto shqetësime.
73. Vendimet me angazhime nuk janë të përshtatshme në rastet kur KK e konsideron natyrën e shkeljes të tillë, që duhet të merret një vendim me vendosje gjobe. Ndërsa vendimi i ndalimit të një shkeljeje përmban një shkelje të gjetur, vendimi me angazhime, i bën këto të fundit detyruese pa arritur në përfundimin nëse ka patur apo ka akoma një shkelje. Një vendim me angazhime vendos se procedurat nuk do të vijojnë më tej. Angazhime ofrohen nga ndërmarrjet vullnetarisht.

VII. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

VII.1. Gjuha

74. Në përputhje me nenin 20 të KPrA, procedimi administrativ duhet të zhvillohet në gjuhën shqipe.

VII.2. Konfidencialiteti dhe kufijtë e përdorimit të informacionit

75. Në të gjitha fazat e procedurës, KK respekton kërkesat nga ankuesit ose nga ofruesit e informacionit në lidhje me natyrën konfidenciale të deklaratave ose kontakteve të tyre me AK.
76. Në zbatim të nenit 30 të ligjit nr.9121/2003 dhe rregullimit të nenit 32 të Rregullores së Funkcionimit, përfaqësuesit e AK janë të detyruar të respektojnë sekretin profesional.

VII.3. Rishikimi në të ardhmen

77. Ky udhëzim mund të rishikohet për të pasqyruar ndryshime në legjislacionin në fuqi, zhvillime të rëndësishme në praktikën gjyqësore ose përvojë të mëtejshme gjatë zbatimit të rregullave të konkurrencës.